

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 17. 10. 2002.

PRISHTINË, tetor 2002.

TRANSKRIPT I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 17.10. 2002.

MBLEDHJA FILLOI NË ORA 10,10.

KRYESUESI I MBLEDHJES: NEXHAT DACI, KRYETAR I KUVENDIT.

Deputetë të nderuar, mirëmëngjes. Mirë se keni ardhur në seancën plenare. Rendin e ditës dhe materialet e duhura shpresoj se i keni marrë me kohë, prandaj nëse ka dikush për rendin e ditës, a po e miratojmë kështu apo jo. Urdhëro, Nojkiq.

RANDJEL NOJKIĆ:

Gospodine predsedavajući, dame i gospodo. Najnoviji događaji koji su se desili u Klokotu, Peći - patriaršiji i sve ono što se događa za srpsku zajednicu mislim da je trebalo da upozori Predsedništvo i da Predsedništvo stavi jednu kao tačku na dnevnom redu i da se raspravlja uoči lokalnih izbora o stanju i bezbednosti srpske zajednice. Diskriminacija, nasilje i teror je prisutna na svakom koraku. Ono što se desilo u Klokotu je samo jedan primer i ono što se dešavalo unazad godinu dana. Pre godinu dana je bilo slično ubistvo, sada se desilo jedno isto tako. Svedoci smo bili u Peći da su bili napadnuti penzioneri. Proglašen je voz multietnički koji može slobodno da ide u relaciji Kosovo Polje – Lešak, on se svakog dana kamenjuje, on svakog dana biva napadan, putnici u njemu maltretirani i svakog trenutka ovaj voz ako nastavi ovako - da ne bude multietnički, da ne mogu u njemu Srbi da se voze.

Ovih dana smo svedoci da Srbe pozivaju na izbore, da Srbi izadju na izbore, međjutim Srbi sve više motivišu da ne izidju na ovim izborima. Ne da ih bojkotuju nego

jednostavno nemaju šta da traže u institucijama sistema kada smo svedoci da i u institucijama sistema Srbi su diskriminirani.

Zadnjih meseci se usvajaju mnogi zakoni i svi čitamo da postoje radne grupe koje su predlagači zakona a ni u jednoj grupi nema nijednog Srbina. Šta to znači? To znači čista diskriminacija u institucijama sistema. Obećava se Srbima da će posle izbora da im se udovolje zahtevi a slična obećanja smo imali i ranije. Obećanja smo imali i prije izbora a imamo situaciju kakvu je imamo. Prema tome sve ovo zahteva da se po hitnom postupku postavi pitanje sigurnosti i bezbednosti Srpske zajednice, diskriminacije, kršenja ljudskih prava, nepoštovanja Rezolucije 1244, nepoštovanje Ustavnih okvira, nepoštovanje Poslovnika i tako dalje, i tako dalje. Znam da ste nervozni, ja nisam nervozan. Znam da ste nervozni a ja ću da vam kažem i na još jednu diskriminaciju...

KRYESUESI:

Nojkiq, është rendi i ditës, nuk e kemi këtë për debat, propozoni diç për rendin e ditës e pastaj do të diskutojmë - ju lutem.

RANDJEL NOJKIĆ:

Da, upravo sam to hteo sada da kažem. Vi ste stavili ovde u dnevni red – usvajanje zapisnika sa prethodne sednice, a ne znam da li ste videli kakav je zapisnik. Pre svega zapisnik smo dobili tek jutros. Ja sam juče bio u Skupštini i nije ga bilo. Jutros smo dobili zapisnik i taj zapisnik je samo na srpskom jeziku u onom delu gde su Srbi govorili. Prema tome mi ne možemo da govorimo o validnosti zapisnika i mislim da ovakve stvari ne trebaju i ne smeju više da se dešavaju. Molim vas, moj konkretni primer je da se pod hitnom postupku uvrsti u dnevni red bezbednost Srpske zajednice i poštovanje Rezolucije, Ustavnih okvira i svih ostalih dokumenata. Hvala.

KRYESUESI:

Unë mendoj se zoti Nojkiq i di rregullat në punën e Parlamentit, sepse është shumë aktiv në të. Mund të diskutohen të gjitha çështjet. Çështjet e sigurisë në Kosovë do të jenë me prioritet dhe atë e kanë kërkuar shumëherë edhe deputetët shqiptarë dhe do të ishte shumë mirë ta ngrisje zërin shumë më herët. Zoti Nojkiq e di që një e treta e Kosovës nuk kontrollohet nga institucionet e Kosovës. Zoti Nojkiq duhet ta dijë që në atë një të tretën e Kosovës as KFOR-i nuk ka akses të plotë, e mos të flasim për UNMIK-un e për këto dhe asnjëherë nuk keni ngritur zërin për këtë. Ndërsa, shqetësimet që i keni ju për sigurinë e serbëve, plotësisht pajtohem me këtë të gjithë dhe qëndrojnë shqetësimet për qytetarët e Kosovës dhe bashkërisht institucionet e Kosovës po luftojnë që të marrin përgjegjësi më të mëdha, më të mëdha në të gjitha lëmitë. Është kërkesë e vazhdueshme e të gjithë deputetëve, e Qeverisë, e kryetarit të Kosovës që përgjegjësitë të kalojnë mbi vendorët sa më shpejtë që është e mundur në të gjitha lëmitë dhe të debatojmë të gjithë këtu. Prandaj ju lutem të mos ketë debate paraelektorale në Parlament. Keni propozuar të futet në rend të ditës çështja e sigurisë në Kosovë. Kjo do të shqyrtohet me procedurë të rregullt, ju e dini, në qofët se përkrahet edhe nga ndonjë grup parlamentar tjetër mund të vendosim për një seancë tjetër. Tani është çështja për rend të ditës të miratohet. Ne dëgjuam propozimin tuaj dhe nuk keni nevojë të kërkonit fjalën më tutje.

Pyes deputetët – a aprovohet rendi i ditës?

Kush është për këtë rend të ditës, ju lutem? Le të numërohen votat.

Kush është kundër rendit të ditës, të propozuar në materiale, le ta ngrisë dorën.

A abstenon ndokush nga votimi? Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For:69

Kundër – Protiv – Against:10

Abstenuan – Uzdržanih – Abstained:.....?

Procedojmë, pra sipas rendit të ditës.

Pika e dytë e rendit të ditës është Procesverbali nga mbledhja e kaluar. Unë mendoj se procesverbali iu është dërguar me kohë deputetëve. Në qoftë se vërtetë nuk iu është dërguar me kohë, por unë kam informim se me kohë iu është dërguar, unë mendoj se

mund ta shqyrtojmë procesverbalin, nëse ka plotësime ose mospajtime ato do të korigjohen në versionin përfundimtar.

STOJANKA PETKOVIĆ:

Ja imam primedbu ne samo po pitanju da li je zapisnik dostavljen u odredjenom roku nego ono što je malopre rekao gospodin Nojkic. Znači srpski poslanici ne mogu da razumeju celi tekst zapisnika i u tom smislu hoću da kažem da zapisnik treba da bude dostavljen na jeziku na onom kojemu mi razumemo da bi znali da pročitamo i da vidimo da li zaista stoje diskusije koje su naše kolege Albanci diskutovali na prethodnoj sednici. Mislim da na to imamo pravo i to je jedna moja primedba. Iskoristiću priliku a koje nije na dnevnom redu, da dostavim pošto sam već izašla, nešto što se slično desilo. Dobili smo, znači u našim fahovima, službeni memorandum koji je takodje samo na albanskom jeziku, budžetski izveštaj od avgusta 2002. godine samo na albanskom ili pak na engleskom jeziku. Ja vas molim da ispoštujete naša ljudska prava, to znači pravo na jezik i na razumevanje. Hvala.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Të gjitha këto vërejtje që janë me vend duhet të aplikohen dhe të respektohen. Për këtë e keni përkrahjen sepse është e drejtë, prandaj procedojmë. Ju falemndedit. Urdhëro.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju përshëndes të gjithëve. Mendoj se procesverbali është në nivel shumë të kënaqshëm por dola vetëm për shkak të një fjale që ia ndërron kuptimin, po mendoj në një pasus këtu. Sa i përket koalicionit "Kthimi" derisa është gjithëherë pikëreferimi këtu është bërë "programi" e duhet "Beogradi" sepse pikëreferimi natyrisht se duhet të jetë, për këtë dola dhe në vend të "programit" të jetë "Beogradi". Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit shumë. E ka fjalën Mevlude Saraçi.

MEVLUDE SARACI:

I nderuari kryetari, e nderuara Kryyesi, të nderuar deputetë. Unë nuk do të zgjas por e shoh se me një fjali që e kam përshkrue diskutimin tim është një shtrebbërim sepse unë atë ditë kam theksue për sigurinë e të gjithë deputetëve dhe në veçanti për rastin tim ku unë nuk jam ndaluar në rrugë në fushatë por unë kam marrë një ftesë prej policisë që të paraqitem në hetuesi, prandaj unë kam dëshirë që në bazë të dokumentacionit të cilin ua kam dorëzuar juve shoku kryetar, prandaj le të plotësohet kjo. Domethënë nuk e kam shqetësimin sepse si deputet nuk kam qenë në fushatë por pikërisht në zyrën time më ka ardhur ftesa prej policisë për arrest prej një orësh.

KRYESUESI:

Të falemnderit. Do t'i korigjojme të gjitha lëshimet. E ka fjalën zoti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI:

Unë nuk kam vërejtje thelbsore shumë - rreth çështjeve të trajtimit të diskutimeve, por kam vërejtje te kryesuesi i seancave dhe kjo del edhe për procesverbalin i cili është dhënë në diskutim dhe miratim. Nga procesverbali në fjalë del se Nexhat Daci na i ka mbajtur 25 fjalime në seancën e kaluar ndërsa kanë diskutuar 23 deputetë. Mendoj se procedura që duhet të ndihqet në parlament nga kryesuesi i seancës duhet të jetë krejt tjetërfare dhe duhet t'i qaset krejt në tjetër mënyrë. Mendoj se humbim kohë dhe po lodhemi e po i shkurtojmë mbledhjet për shkak të lodhjeve dhe nuk po i trajtojmë problemet përmes procedurës së votimit e cila duhet me qenë në parlament rreth trajtimit të problemeve. Mendoj se kryesuesi i seancës nuk ka nevojë t'i komentojë diskutimet e deputetëve por t'ua merr apo t'ua japë fjalën dhe t'i hedhë në votim propozimet.

KRYESUESI:

Falemnderit. E ka fjalën Sllobodan Bijeliq.

SLOBODAN BIJELIĆ:

Poštovano Predsedništvo, članovi Skupštine i Vlade, imam primedbu na zapisnik na strani 2. Citirano je da je u diskusiji učestvovao gospodin Randjel Nojkić, a radi se o mojem malenkosti, znači celu ovu priču sam ispričao ja. To znači da treba makar ispoštovati u elementarnom smislu navode naših članova Skupštine odnosno ne prepisivati diskusije članova drugim licama. To je jedno, i da ne bih se ponovo pojavljivao za govornicom, ja bih iskoristio pravo da apostrofiram i materijal koji je došao sa sednice Odbora za finansije i privredu. Mislim da neki navodi koji su dati kao izveštaj tog Odbora nisu u redu i ne odgovaraju činjenicama koje su se dogodile na samom sastanku. I to bi bilo sve. Zahvaljujem.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. E ka fjalën shoku Sabit Rrustemi.

SABIT RRUSTEMI:

Zoti kryetar, Kryesi e nderuar dhe deputetë. Ne edhe herave të kaluara kemi shtruar çështjen e gjuhës, por ajo nuk është evituar ende. Kërkoj që herave tjera, së paku procesverbali të na lektorohet. Një, dhe tjetra, unë nuk e di kush dhe nga diskutuesit tjerë që kemi të bëjmë edhe me procesverbalet tjera multietnike, unë për herë të parë sot po ballafaqohem. Edhe në procesverbalin në gjuhën shqipe diskutimet e deputetëve serbë janë dhënë vetëm në gjuhën serbokroate, për çka konsideroj se kjo nuk është në rregull. Tek çështja që unë kam kërkuar rreth ardhjes së zotit Shtajner në seancën e Kuvendit, ndoshta edhe për shkak të gabimeve gjuhësore, fjalia ka dalur krejt e pakuptueshme. Unë kam thënë jo pse do të ketë efekt, por sa do të ketë efekt ta shpalesë sot në këtë seancë programin për Mitrovicës.

KRYESUESI:

Falemndedit. E ka fjalën zoti, Sadudin Berisha.

SADUDIN BERISHA:

I nderuari kryetar, - në faqën 5 të procesverbalit, pjesa e diskutimit tim paksa është shtrembëruar. Është thënë - "Komisioni për të drejtat e komuniteteve është takuar të hënën" dhe në fund të fjalisë thuhet "janë mbështetur në parim", ashtu si është thënë dhe vazhdohet me fjalinë "dhe natyrisht është kundërshtuar nga Komisioni". Kur është mbështetur në parim, si mund të kundërshtohet nga Komisioni? Kështu vërtetë është alogjike kjo.

KRYESUESI:

A kush tjetër të paraqitet? Ju falemnderit. Duhet të përmirësohen të gjitha gabimet që janë paraqitur nga deputetët. Kush është për aprovim me të gjitha korigjimet që duhet bërë? Numëroni votat. Kush është kundër aprovimit? Kush është kundër? A abstenon ndokush?

Votimi - Glasanje – Voted:

Për – Za – For 76,

Kundër – Protiv – Against 3,

Abstenuan – Uzdržanih – Abstained..... -

Ju falemnderit. Konsideroj se me përmirësimin e propozimeve nga deputetët është aprovuar dhe se 76 deputetë kanë votuar për aprovim.

Vazhdojmë me rendin e ditës. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Hipotekat. Ju e dini që ky ligj në parim është aproovuar. Duhet të them se një mori problemesh po e përcjellin punën normale të Parlamentit dhe të shpresoj se kjo do të jetë seanca e fundit me kaq probleme. Besoj se amendamentet i keni marrë të gjithë me vonesë dhe unë vazhdimisht e theksoj

problemin që po e përcjell punën e komisioneve dhe të deputetëve dhe këtë në të gjitha nivelet dhe megjithatë është e patolerueshme më. Unë po ua tërheq vërejtjen komisioneve dhe deputetëve – në qoftë se në kohë të caktuar nuk kanë mundësi të takohen dhe të punojnë, ne do të konsiderojmë që ligji ish i aprovuar në parim nuk ka vërejtje dhe amendamente dhe do ta qesim në debat për aprovim herave tjera. Nuk mund t'i lejojmë më luks vetëvetes e të mos kryhen punët me kohë.

Unë mendoj se në këtë ligj është një numër i vërejtjeve që kanë të bëjnë me versionin në gjuhën shqipe. Të gjitha ato vërejtje shpresoj se janë të sintetizuara nga Komisioni për buxhet, janë vërejtje të natyrës profesionale-gjuhësore, jo thjesht gjuhësore, prandaj shpresoj se profesionistët përfundimisht janë akorduar për nocionet e caktuara për nomenklaturë të caktuar dhe në parim të gjitha ato janë përkrahur në Komisionin për buxhet dhe ju propozoj që të mos humbim kohë në debate si të thuhet ajo fjalë apo kjo fjalë. Ndërsa, për amendamentet e caktuara do të thojë sa për fillim në qoftë se ka ndonjë sqarim ministri i Shërbimeve Publike, zoti Jakupi, ose unë kam informatë se atë do ta bëjë zoti Berat Luzha, nuk e di a është e sakt apo jo, ose të shkojmë amendament pas amendamenti e të kalojmë në punë. Sa e shifni të arsyeshme zoti ministër? Urdhëroni.

JAKUP KRASNIQI:

Të nderuar deputetë, i nderuari kryetar. Ministria e Shërbimeve Publike ka disa amendamente të parashtruara dhe këto kryesisht vijnë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, e cila ka bërë harmonizime mes Ligjit mbi regjistrimin e të drejtës së pronës së paluajtshme dhe Hipotekat. Ministria e Shërbimeve Publike i propozon disa amendamente të vogla. Këto amendamente praktikisht Projektligji mbi hipotekat ia përshtasin Projektligjit mbi regjistrimin e të drejtës për pronat e paluajtshme. Amendamentet përfshijnë: 1. Ose e para: Preambula i është shtuar Ligjit. Kjo preambulë shpreh se Projektligji mbi hipotekat do të jetë objekt i kodit të tokës në të ardhmen i cili do të rregullojë çështjet e përgjithshme lidhur me pronën në Kosovë. E dyta, definicionet e Projektligjit mbi hipotekën dhe shprehjet në të i janë përshtatur Projektligjit mbi regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme në mënyrë që të sigurojnë koherencën e të dy ligjeve. Dhe, e treta: bartja e hipotekës do të kufizohet në bartjen e kërkesës së siguruar me hipotekën. Kjo lidhje e krijuar në mënyrë më të mirë në mes të hipotekës dhe kërkesës ka mbetur disi e paqartë në Projektligj. Prandaj, kisha dëshiruar që Projektligjit amendamentet e propozuar t'i shtohen sepse kam bindjen këto amendamente e plotësojnë Ligjin mbi hipotekat.

KRYESUESI:

Ju falemnderit ministër. Unë do të ftoj zotri Shatrin, si udhëheqës i Komisionit për buxhet, për vërejtjet në parim që janë aprovuar.

HAKI SHATRI:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë, Komisioni për buxhet e ka shqyrtuar Projektligjin për hipotekën e po ashtu edhe Projektligjin për regjistrin e pasurisë së patundshme. Në periudhën e parë derisa ka mbërri edhe Amendamenti nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike, Komisioni për buxhet e ka rrumbullaksuar punën e tij dhe ka dhënë vërejtje të cilët shkojnë paralelisht me punën e Komisionit edhe janë korigjuar nga një komision i veçantë dhe të cilët janë ekspertë pranë Kuvendit për ndihmë Kuvendit. Do ta kisha përmend këtu dhe falënderuar publikisht zonjën Xhemi i cila disa herë me radhë ka ardhë personalisht dhe është konsultuar derisa e ka përfunduar një version të lektoruar dhe të rregulluar të Ligjit për hipotekën.

Vërejtjet tjera të cilat i ka bërë Komisioni për buxhet janë inkorporuar në tekstin që e përmenda i cili u është dërgue për procedurë të mëtejme të premtën e kaluar strukturave administrative të Kuvendit dhe besoj se ato iu kanë ndarë edhe deputetëve tani. Duhet të them, me keqardhje, se amendamentet e grupit parlamentar të Partisë Demokratike Komisioni për buxhet nuk ka qenë në gjendje t'i diskutojë dhe të marrë qëndrim të caktuar për arsye të mungesës së kuorumit. Komisioni për buxhet është thirrur dhe është mbledhur 2 herë, të hënën dhe dje për herë të dytë dhe për fat të keq vetëm 4 anëtarë të Komisionit kanë marrë pjesë në mbledhje. Për këtë çështje besoj se ky Kuvend do të marr një qëndrim të caktuar e ne mund të marrim qëndrim dhe kisha propozuar që Komisioni të mblidhet ad-hok e të jepë mendimin e tij në këtë amendament dhe sa i përket mendimit tim personal, të gjitha propozimet që janë bërë në amendament, plotësimet për mua janë të pranueshme sepse ato e begatojnë tekstin dhe e rrisin nivelin e një dokumenti siç është Ligji mbi hipotekat, por procedura megjithatë mendoj se duhet të respektohet. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Ne kemi planifikuar kësisoj, që t'ia japim fjalën nëse ka dëshirë zotri Berat Luzha, pastaj zonjës Nerxhivane Dauti, e do ta kemi një pauzë 30 minutash dhe pastaj t'i

ftoj të dy komisionet na sallat 10 dhe 17 që të japin mendimet e tyre dhe pas 30 minutash do të vazhdojmë. Zonja Nerxhivane apo zoti Berat, çili të dojë le ta marrë fjalën.

BERAT LUZHA:

Të nderuar deputetë. Te rasti im është një keqkuptim shumë i madh sepse nuk i kam bërë unë këto ligje dhe këtu është përvjedhë një gabim i rëndë mendoj, sepse emri im paraqitet në shumë amendamente kurse unë i kam bërë vetëm disa vërejtje, i kam bërë me gojë dhe ato ishin të natyrës teknike në tri nenet e fundit dhe ato ka qenë në Projektligjin mbi tregtinë e jashtme. Domethënë, unë nuk kam bërë asnjë amendament në këto dy projektligje. Është një gabim shumë i rëndë. Unë nuk kam shpjegim!

KRYESUESI:

Unë mendoj se nuk duhet të përsëriten këto gabime. I kërkoj falje shokut Berat Luzha. Urdhëroni zonja Dauti.

NERXHIVANE DAUTI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Projektligji për Hipotekat, paraqet një bazë të rëndësishme juridike që siguron të drejtat e hipotekës mbi paluajtshmëritë dhe i cili vendos mekanizmat për fuqizimin e shpejtë dhe efektiv të të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

Hipotekat në sendet e paluajtshme janë rregulluar në mënyrë fragmentare në Ligjin mbi marrëdhëniet juridiko-pronësore të vitit 1980 të ish Jugosllavisë, ligj i cili, mjerisht, ende zbatohet si ligj i aplikueshëm në Kosovë.

Ligji i cekur rregullimin juridik të hipotekave e bënë në nenet 61 deri 69. Neni 62 i referohet rregullave mbi pengun e pasurisë së luajtshme. Këto rregulla janë tradicionale dhe shumë të vjetëruara sepse ato merren vetëm me të ashtuquajturin pengun posedues të sendeve ku pasuritë e lëna peng duhet t'i transferohen kreditorit ose personit të tretë. Këto rregulla tani zëvendësohen me Ligjin e ri për hipotekat, i cili bazohet në një qasje moderne

meqenëse i njëjti i lejon pengut joposedues ku debitori mund të mbajë posedimin dhe përdorimin e mallrave të marrura peng. Ligji i ri mbi hipotekën kërkon por edhe ofron detaje më të mëdha ku në tërësinë e vet përmban 24 nene. Ky ligj përcakton:

1. Mjetet ekskluzive për krijimin e hipotekave,
2. Efektet e tyre juridike ndërmjet palëve dhe personave të tretë,
3. Mjetet sipas të cilave hipotekat e caktuara nga organizatat e biznesit mund të ekzekutohen me rrugë jashtgjyqësore në rast të mospërmbushjes sipas kushteve të kërkuara të dokumentit të hipotekës.

Anë pozitive e këtij ligji është zhvlerësimi i dispozitave të përmbajtura në Ligjin e aplikueshëm që e kanë rregulluar materien në fjalë. Sa u përket vërejtjeve të veçanta, unë këto ia kam prezentuar Kryesisë së Kuvendit në emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, andaj këto edhe nuk do t'i përsëris.

Vlenë të theksohet se si pikënisje fundamentale, ekonomia e tregut kërkon të drejtat e definuara mirë, të sigurta dhe të zbatueshme të pronës private.

Sistemi i tanishëm i të drejtave të pronës në Kosovë, posaçërisht në sferën e paluajtshmërisë, duhet të modernizohet, rishikohet dhe zgjerohet. Është më se e nevojshme dhe domosdoshme që të fillojë puna për një ligj gjithpërfshirës për pronësi i cili do të siguronte mbulesë të detajizuar të të gjitha të drejtave bazë të pronësisë dhe çështjet lidhur me pronësi siç janë: posedimi, servitutet reale, personale, barrët, pengu dhe mjetet juridike për mbrojtjen e tyre.

Edhe pse theksohen arsyetime se për një punë të tillë kapitale për Kosovën duhet kohë që ky ligj gjithpërfshirës të finalizohet. Mendoj se urgjentisht duhet filluar puna në drejtim të hartimit të Ligjit të përmendur. Nga ana tjetër, duhet bërë përpjekje për të finalizuar një varg ligjesh që janë esenciale për rimëkëmbjen ekonomike të Kosovës. Posaçërisht ligjet vijuese janë të nevojshme në një afat sa më të shkurtër kohor:

1. Ligji i ri i Detyrimeve të Kosovës,
2. Ligji i Procedurës Kontestimore,
3. Ligji i Përmbarimit, dhe

4. Ligji mbi organizimin e Gjykatave.

Për ta nisur dialogun dhe për ta ngritur vetëdijen për nevojën e një reforme të legjislacionit të ekonomisë së tregut, rekomandimet janë përgatitur nga një numër ekspertësh nga Gjermania dhe Austria.

Gjatë një seminari njëjavor, në shkurt të vitit 2002, në Institutin Maks Plank për të drejtën e huaj dhe për të drejtën ndërkombëtare private në Hamburg të Gjermanisë, anëtarët e Grupit punues vendor u takuan me ekspertët ndërkombëtarë që të krijojnë rekomandimet për ligjet e lartpërmendura.

Rekomandimet karakterizohen nga shtatë parime themelore, prej të cilave, sundimi i ligjit dhe orientimi nga ekonomia e tregut janë më të spikaturat.

Nga tërë kjo që theksova, mund të konkludoj se ekziston një nevojë këmbëngulëse për reformë ligjore në Kosovë në fushën e marrëdhënieve juridiko-civile. Unë si deputete dhe eksperte e së drejtës së detyrimeve dhe profesoreshë e kësaj lënde në Fakultetin Juridik, shtroj iniciativën për procedurën legjislative nga Kuvendi për këto ligje:

1. Ligjin e Pronës së Kosovës,
2. Ligjin e Detyrimeve,
3. Ligjin e Procedurës Kontestimore dhe të Përmbarrimit.

Ju falemnderit për vëmendje.

KRYESUESI:

J u falemnderit. E ka fjalën Stojanka Petković.

STOJANKA PETKOVIĆ:

Poštovani predsedavajući, gospodo poslanici. Ja želim da se nadovežem na diskusiju Haki Šatrija. Hoću da kažem da verovatno nije imao kvorum iz razloga zato što srpski poslanici

nisu mogli da dodju na zadnja dva sastanka da učestvuju u radu Odbora jer nam nije obezbedjen prevoz. Takodje, za juče, nisam dobila poziv od strane koordinatora koji učestvuje u radu za Komisiju za budžet i kao član Komisije za budžet iz tog razloga nisam mogla da prisustvujem. Pitanje našeg transporta utiče na naš rad odnosno na nerad i prisustvo na našim odborima i tako smo sprečeni da na blagovremen način - znači iznesemo naše mišljenje i osim toga i naše amandmane koji su potrebni prilikom donošenja nekih zakona. Ja vas molim da se ovakve stvari više ne ponavljaju jer u zadnje vreme ovo se permanentno pojavljuje i ovo zaista više nije slučajnost. Inače, ako se ovakve stvari ponovo događaju, mi ćemo shvatiti da je ovo blokada na rad srpskih poslanika. Hvala.

KRYESUESI:

Zonja Nekibe Kelmendi, pastaj Bujar Dugolli.

NEKIBE KELMENDI:

Të nderuar deputetë. Unë do t'i referohem Amendamentit në hipotekat të propozuar nga ministri i Shërbimeve Publike. Preambula është plotësisht në rregull dhe neni 2 plotësisht në rregull, mirëpo formulimi apo përkufizimi i termit hipotekë është krejtësisht i gabuar. Ndoshta është bërë ndonjë përkthim nga gjuha angleze dhe përkthimin e ka bërë ndonjë gjuhtarë e jo jurist që nuk ka sens juridik dhe vërtetë nuk mund të kuptohet asgjë se çka nënkuptojmë me nocionin hipotekë, ndërsa ne juristët e dijmë se hipoteka do të thotë vënie dorë në patundshmërinë e dikujt derisa kreditori t'i realizojë kërkesat e veta dhe ato çështjet tjera që pasojnë.

KRYESUESI:

Nekibe, të lutem i lëmë amendamentet pas pauzës. Në parim nëse ke diçka atëherë vazhdo.

NEKIBE KELMENDI:

Nuk po e ... Prona afariste nuk e dij çka nënkupton, mundet me qenë objekt afarist ose patundshmëri afariste. Prona është private apo shtetërore...

KRYESUESI:

Të falemnderit. Urdhëro zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Të nderuar deputetë. Edhe nga këto diskutime vërehet se ka qenë e panevojshme shtyrja, në seancën e kaluar, të miratimit të këtyre dy ligjeve. Në fakt, vijnë kërkesa dhe nuk iu dërgohen komisioneve përkatëse për t'i shqyrtuar këto. Kështu ka ndodhur edhe me kërkesën e koalicionit "Kthimi", ndërsa me kërkesën e deputetës së Partisë Demokratike kanë qenë vërejtje parimore dhe ne kështu i kemi kuptuar dhe nuk iu kanë drejtuar komisionit përkatës. Prandaj iu kisha lutur të gjitha grupeve parlamentare të cilët kanë deputet në të gjitha komisionet të bashkëpunojnë me anëtarët e tyre dhe të mos bëjnë amendamente shtesë por t'i ofrojnë anëtarit të partisë së vet që e ka prezent në komisionin përkatës dhe kështu ta lehtësojmë punën tonë.

Komisioni për shërbime publike, në mbledhjen e mbajtur me 2.10, pasi që unë jam zëvendëskryesuesi i parë dhe e kam udhëhequr këtë mbledhje, kemi bërë disa propozime edhe për Kryesinë e Kuvendit prandaj ndiej të nevojshme t'i paraqes këtu.

Komisioni për shërbime publike i Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 2.10, ka shqyrtuar Projektligjin për Hipotekat dhe Projektligjin për krijimin e regjistrit të të drejtave mbi pronën e paluajtshme dhe ka konstatuar si vijon:

Nën 1. Te Projektligji mbi Hipotekat, te neni 7.2. të shkruhet "një ndryshim i dokumentit të hipotekës do të ketë efekt pas regjistrimit në përputhje me ligjin". Të hiqet fjala

"zbatueshëm" , d.m.th. ligji i zbatueshëm që ekziston në këtë projektligj e që është paraqitur në Kuvend.

Nën 2. Te neni 14g të shkruhet: "çdo element tjetër të pajtuar nga pengdhënësi dhe pengmarrësi që nuk ndalohet me këtë ligj". Të shlyhet pjesa përfundimtare që thotë "ose ndonjë ligj tjetër të zbatueshëm", sepse konsiderojmë pas miratimit të këtij ligji nuk mund

të ketë ndonjë ligj tjetër që e zëvendëson këtë çështje. Pra, kërkesa e Komisionit është që çdo vend ku është futur termi "ligj i zbatueshëm" të shlyhet nga ky ligj.

Nën 3. Te kapitulli 6, në vend të "dispozitave të përziera" të shkruhet "dispozitat përfundimtare".

Nën 4. Te neni 24, të fshihet fjala "ligj i zbatueshëm". Ky nen propozojmë të jetë kështu: "Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushojnë së ekzistuari ligjet dhe dispozitat e tjera që më parë e kanë rregulluar këtë çështje".

KRYESUESI:

Bujar, të lutem kjo vlenë sikur edhe te zonja Kelmendi. Do ta kemi këtë në debat më vonë. I thatë ato parimore dhe nëse keni ende diçka parimore urdhëroni.

BUJAR DUGOLLI:

Në rregull, këto janë kërkesat e Komisionit. Unë e ndiej veten të obligueshëm t'i paraqes, nëse keni durim e nëse jo, unë mund t'i lë. Falemnderit.

KRYESUESI:

Tomë Hajdari ka kërkuar, pastaj profesori Fatmir Sejdiu.

TOMË HAJDARAJ:

I nderuar kryetar, kolegë të dashur. Meqenëse është fjala faktikisht për dy ligje të rëndësishme që i kemi domethënë në diskutimin e dytë, unë kam disa vërejtje parimore, po flas në emër edhe të Komisionit parlamentar për bujqësi nga mbledhja e kaluar që kemi shqyrtuar. Si deputetë në veçanti s'kemi prurë kështu konkluzion të përbashkët por duke

parë rëndësinë dhe emergjencën e hartimit të këtyre ligjeve, posaçërisht të atij mbi regjistrin mbi pronën e patundshme unë kisha vetëm për ta cituar zonjën Kelmendi e cila që nga diskutimi i parë ka kërkuar që së pari të kërkohej dokumentat kadastralë të marrur pra nga ish sistemi, pra nga Kosova në Serbi, kush në cilën komunë. Pra, të kthehen dokumentat origjinalë në mënyrë që të kemi situatën faktike të regjistrave kadastralë. Ndërsa, sa i përket asaj që thotë ministri, Agjencioni Kadastral i Kosovës ka bërë regjistrin e pronës së paluajtshme dhe të hipotekave. Unë kisha me thënë se nuk ka mundësi të bëhet përderisa mungojnë dokumentat origjinalë.

Sa i përket pjesës që zonja Dauti e potencoi për hartimin e Ligjit mbi pronën, është domosdo e kohës dhe mendoj se a mos jemi ngutur sepse së pari është dashur ta kemi në procedurë Ligjin mbi pronën dhe pastaj Ligjin mbi regjistrin e paluajtshmërisë. Do të thotë këtë e mbështesë dhe është domosdo. Ndërsa, sa i përket regjistrave të cilët janë bërë posaçërisht nga viti 1989 e deri në vitin 1998, kërkoj nga komisionet të cilat do të ulen dhe të kenë parasysh sepse e deshëm apo s'e deshëm aty janë bërë dollovere nga më të ndryshmet dhe mos e dhashtë zoti të vijmë deri te ndonjë konflikt i ish pronarëve apo i njerëzve të cilët kanë prona. të cilët kanë 3-4 pronarë. Këtu duhet të kemi parasysh këtë dhe komisionet të kenë konsideratë lidhur me këtë veprim në mbledhje të cilat do t' i kenë në afatin e ardhshëm. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Urdhëroni zoti Fatmir Sejdiu.

FATMIR SEJDIU:

Falëmnderit zoti kryetar, e nderuara Kryesi, të nderuar deputetë. Unë desha vetëm dy-tre elemente të cilët kanë natyrën parimore të punës së mëtejshme që duhet ta bëjmë. Nga diskutimi i zotit Shatri pamë se pengesat që janë paraqitur në punën e komisioneve kanë reflektuar edhe në një version final ta quajmë të akumulimit të debatit lidhur me amendamentet e shtruara. Unë me këtë rast do të përshëndetja hapin tuaj se megjithatë duhet të bëhet një koordinim i sotëm dhe besoj se deputetët kanë pasë vërejtjet edhe më herët. Një çështje duhet ta kemi parasysh – nuk mund të shkojmë me versione paralele rreth një projekti të ofruar sikur që është vepruar sot. Ne kemi një version të datës 23

gusht, kemi një version të datës 11 tetorit. Të 11 tetorit e kemi marrë sot. Debatimi në parlament bëhet për një version unik. Të kihet parasysh që në rastet e ardhshme, edhe pse s'mund të ketë ndryshime të shumta në këtë rast të ofruar, në rastet e ardhshme megjithë përpjekjet të shtrohet një version rreth të cilit do të debatohet. Vërejtjet, sugjerimet dhe çështjet tjera që kanë për qëllim të begatojnë normën e secilës pjesë, pra të ligjit apo të projektligjit të ofruar, ato do të jenë por jo një shkapërderdhje dhe ne tash të kërkojmë se ku është apo si është. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Të falemnderit zoti Sejdiu. 30 minuta pauzë, për dy komisionet në 10 dhe 17 ju lutem t' i harmonizoni çështjet dhe pastaj vazhdojmë. Ju falemnderit.

PAUZA PREJ 30 MINUTASH.

* * *

PAS PAUZËS MBLEDHJA VAZHDOI PUNËN

KRYESUESI NEXHAT DACI, KRYETAR I KUVENDIT:

Unë mendoj se mund të vazhdojmë me punë. Para se të ftoj kryesuesit e komisioneve dhe të procedojmë me amendamente të veçanta, më lejoni t'i dëshiroj mirëseardhje deputetit të ri, zotit Hasan Meta, nga LPK, i cili e zëvendëson të ndjerin, Bedrush Çollakun. Mirësevini në Parlament, zotëri.

(Pason duartrokitja)

Unë do të doja të merremi vesh për një procedim. Çështjet e përgjithshme që ishin profesionalo-gjuhësore të inkorporohen në ligj. Të gjithë janë për atë, nuk kemi çka, prandaj të shkojmë nen për nen. Do të thotë, në preambulë, besoj zoti Berat Luzha që po figuron këtu, do të thotë, unë besoj se është Ministria e Shërbimeve Publike, të hiqet fjala "ekskluziv, neni 1.1." kjo mendoj se është aprovuar në parime nga të dy komisionet dhe nuk e shoh të arsyeshme ta debatohet... Prapë, në nenin 2., unë po i kërkoj falje zotit Luzha por e kam të shkruar kështu, do të thotë të grupit, "parcela e pronës", do

të thotë një pjesë e tokës, e besoj se kjo po ashtu është aprovuar nga të dy komisionet dhe në qoftë se ndokush e sheh të arsyeshme nga propozuesi ose kundërshtuesi që të thotë diçka, urdhëroni por nuk e shoh ndonjë arsye që të humbim kohë për këtë. Neni 3. Nerxhivane Dauti, do të thojë që grupi parlamentar sepse ne në parim u morëm vesh se janë amendamente të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe këtu kanë të bëjnë me çështjet nocionale prandaj e konsideroj si amendament të aprovuar, nëse nuk kanë diçka kundër ndonjëri nga komisionet. Ju falemndedit. Neni 4, ka të bëjë me të njëjtën çështje. Neni 4.5. ka po ashtu grupi parlamentar i PDK, dhe mendoj se edhe kjo po ashtu është e aprovuar nga komisionet, si dhe 4.7. Neni 5 thotë: "duhet të anulohet". A mendohet të anulohet në... Komisioni për buxhet, ju lutem cili është mendimi. Në qoftë se e përkrahni s'ka nevojë me dalë vazhdimisht. Ju falemnderit. Komisioni besoj për interesa të minoriteteve të njëjtën gjë e ka, nuk ka vërejtje. Neni 7, pika 7.2. Besoj se është i përkrahur nga Komisioni për buxhet dhe nga Komisioni i komuniteteve prandaj e konsideroj si të aprovuar, nëse s'ka ndokush ndonjë kundërshtim.

(Diskutohet larg foltores - nuk dëgjohe diskutimi)

KRYESUESI:

Mirëpo, duhet të shkojmë dhe ta dhëmë në fund pastaj. Ndoshta Shërbimet Publike kanë vërejtje në këtë. Mirë, ne po i aprovojmë të gjitha ato që Ministria e Shërbimeve Publike dhe grupi parlamentar i Partisë Demokratike, unë të gjitha ato po i shikoj, nëse janë përkrahur atëherë aprovohen Dugolli, apo keni diçka tjetër.

(Bëhen konsultime, nuk dëgjohe)

KRYESUESI:

Neni 7.2. Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës duhet të përcaktohet në njërin prej formulimeve. Një shkruan këtu që e keni 7.2 Berat Luzha dhe 7.2. prapë Nerxhivane Dauti. Është sugjerimi që njëri nga këto dy arsyetimet, nuk mund të qëndrojnë të dytë të shkojnë. Çfarë është njëherë mendimi i komisioneve? Zoti Shatri

dhe... Atëherë grupi parlamentar, urdhëro Berat. Do të thotë i pari shkon, ajo pjesë që është nën Berat Luzha e kjo tjetra anulohet. Ju falemnderit.

Neni 8. Cili është mendimi i komisioneve? Në qoftë se përkrahen, atëherë thuani që përkrahen. A ka ndonjë deputet që ka ndonjë tjetër mendim? Unë po kërkoj falje, ndokush mund të bëjë vërejtje dhe të thotë se duhet megjithatë ta votojmë. Vetë fakti se janë mbështetur nga komisionet përkatëse e unë po pyes a ka ndonjë deputet tjetër ...kundër? Pra e nënkupton pajtimin në parim dhe nuk po e shof të arsyeshme t'i numërojmë deri sa e kemi sistemin elektronik të votimit. Urdhëro zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Propozimet e Komisionit për Shërbimet Publike për seancën e kaluar kanë qenë të gatshme, ndërsa tash nuk iu kanë shpërndarë deputetëve. Unë mendoj që në rast se keni lënë për në fund të merren parasysh edhe pastrimet e këtyre fjalëve, atëherë në rregull e në rast se jo atëherë këto mund të biejnë në kundërshtim me ato që po i aprovon. Kështu që kërkoj se këtë shkresë që e keni marrë nga Komisioni për Shërbime Publike ta keni në Kryesi ta shqyrtoni dhe të mos e kaloni kështu, sepse kjo ose është dashur t'i u shpërndahet edhe një herë deputetëve ose ju duhet ta keni dhe t'i merrni parasysh: nenin 7.2., 14, nenin 24 dhe 25 të Ligjit mbi Hipotekat. Falemnderit.

KRYESUESI:

Ju lutem vazhdojmë me nenin 8. Urdhëro zoti Prekopuca.

GANI PREKOPUCA:

Neve në Komisionin për buxhet, po flas si anëtar i Komisionit buxhetor u morëm vesh që në këtë moment të shkojë varianti i zonjës Nerxhivane e cila sipas sqarimeve që na i tha zotëriu nga administrata këtu, bjen në kundërshtim me disa nene ky amendament që ka ardhur në Shërbimet Publike, prandaj jam që të shkojë varianti të cilin e ka propozuar dhe të cilin ne si Komision e pranuar parimisht, prandaj po çuditëmi pse ka shukatje këtu. Kaq desha unë.

KRYESUESI:

Falemnderit. Ju lutem është një propozim që është arritur me kohë, nuk është i shpërndarë por që ka të bëjë në parim me terminologjinë, por mendoj se duhet ta përfillim, ta shqyrtojmë dhe votojmë. Është një propozim i Komisionit për Shërbime Publike që e ka shqyrtuar këtu që në tekstin e filtruar përfundimisht, gjithkund të pastrohen fjalët " e ligjeve të deritashme" por të jesis që i vetmi ligj që e definon këtë materie është ligji në shqyrtim e që e konsiderojmë si esenciale dhe mendoj se mund të aprovohet.

Kush është për këtë propozim?

Ju falemnderit. Shumica absolute.

Vazhdojmë. Unë po them se sot do të kemi vështirësi, edhe ju deputetë edhe Kryesia e mbledhjes sepse kur nuk arrihen me kohë të sistemohen, prandaj ju lutem të keni mirëkuptim dhe të jemi produktivë dhe të vazhdojmë. Në nenin 8 janë disa raste, prandaj lus komisionet përkatëse, a i mbështesin? Ju falemnderit. Komisioni i komuniteteve nuk ka vërejtje, domethënë i aprovojnë dhe ne konsiderojmë si të aprovuara.

Neni 10 - janë të njëjtat çështje dhe mendoj se është përkrahja e komisioneve. Ju falemnderit. Do të thotë aprovohen amendamentet e propozuara nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike.

Neni 11. A ka ndokush jashtë përkrahjes, sepse përkrahja është bërë në parim edhe për nenin 12 dhe i konsideroj si të aprovuara.

Neni 14. Besoj të jetë përkrahja e komisioneve për buxhet dhe komisionit funksional dhe konsideroj si të aprovuar.

Neni 15. Në përgjithësi e shoh se ka përkrahje të komisioneve. A ka kush ndonjë propozim. Ju falemnderit.

Neni 17 në tërësi. Është përkrahja parimore e komisioneve në veçanti dhe e konsideroj si të aprovuar.

Neni 18. E njëjta gjë vlenë edhe për nenin 18. Ju falemnderit.

Nenni 19. Përkrahja e komisioneve është. Ju falemnderit. Konsideroj se aprovohet.

Neni 21 në tërësi. Përkrahja e komisioneve është. Ju falemnderit. Aprovohet.

Neni 22. Mendoj se aprovohet amendamenti, nuk ka kundërshtime dhe tani ju lutem duhet ta votojmë në tërësi Ligjin. Më falni para se ta votojmë në tërësi, unë po e shoh se ka ardhur një propozim nga Komisioni i interesave të komuniteteve. Të zëvendësohet thotë, paragrafi 7 neni 2 në definicionin e mëposhtëm. Tash u është ndarë. Unë mendoj se duhet ta përkrahim këtë nen të Komisionit. E përkrahim zotri, nuk keni nevojë me marrë fjalën. Urdhëroni.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Mi smo se u Komisiji za prava i interese zajednica dogovorili da radimo jednom metodologijom koja podrazumeva da ćemo projekte zakona razmatrati sa stanovišta koliko ti zakoni zadiru u prava interesa zajednica odnosno koliko su ti zakoni diskriminatorски i da se prema tome odredjujemo a to i zbog toga što je sastav Komisije takav da u Komisiji sede ljudi različitog obrazovanja. U toj Komisiji sede samo dva pravnik, jedan od tih sam ja za koga ne mogu reći da sam ekspert i prosto je nemoguće da jedna Komisija takvog dakle profesionalnog ili obrazovnog..., takve strukture da može da razmatra zakone sa stanovišta pravne tehnike, njihove saglasnosti sa Ustavnim okvirom i ne znam šta, i onda smo se dogovorili da samo sa tog aspekta da razmatramo zakone. Ja ću da se izvinim mojim kolegama sa ove Komisije, nešto nisam siguran da je baš ovaj amandman bio na Komisiji i istovremeno znači i ne tvrdim, i da nisam u ovome eksplicitan, ali sada moram kao poslanik ispred koalicije "Povratak" da reagujem u sprskom jeziku. Reč "debitor" nije poznata i zato bih se založio da ako je moguće da ostane kao u formulaciji u Projektu "dužnik" ili "zalagodavac", "zalogoprimac" što može sasvim adekvatno i da bude inkorporirano i da zadovolji potrebe ovog zakona. Hvala.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Unë mendoj që neni 25 është i rëndësishëm për hirë të asaj që thash...
A mos deshët ju zoti Dugolli. Urdhëron

BUJAR DUGOLLI:

Komisioni ka konstatuar se atje ku bëhet fjalë për dispozitat përfundimtare duhet të jenë unike në të gjitha ligjet dhe të mos dallojnë njëra prej tjetrës dhe në nenin 24 vendim i Komisionit është që të formulohet kështu: "me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë së ekzistuari ligjet dhe dispozitat tjera që më parë kanë rregulluar këtë çështje", po "pushojnë së vepruari". Dhe, neni 25 të shkruhet kështu: "Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm" dhe mendoj se këto dispozita duhet të jenë në çdo ligj e që të mos na përsëriten çdoherë kur miratojmë ligje. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Unë mendoj se duhet të aprovohet, sepse ne në parim u pajtuam te neni përkatës dhe konsideroj se duhet të futet kjo që tha zoti Dugolli. E kam edhe një problem, ne po pajtohemi me propozimin që e ka bërë Komisioni për mbrojtjen e interesave të komuniteteve e tash kryesuesi del në kundërshtim me këtë. Na ndihmoni për çka duhet të përcaktohem. (Polemikë). Mirë, domethënë aprovohet.

Kush është për këtë aprovim? Ju falemnderit.

Prandaj, në të njëjtën kohë, ju ftoj ta votojmë Ligjin në tërësi me të gjitha amendamentet e aprovuara.

Kush është për aprovimin e këtij ligji? I numëroni votat ju lutem. A ka kush kundër? A abstenon ndokush nga votimi?

Rezultati - Rezultat – Results:

Për – Za – For: 69,
 Kundër – Protiv – Against: 2,
 Abstenuan – Uzdržanih – Abstained: 8.

Konsideroj se ligji është aprovuar. Ju falemnderit.

(PASON DUARTROKITJA)

STOJANKA PETKOVIĆ:

Mislim da je ovom prilikom napravljena povreda Poslovnika s obzirom da samim tim tamo stoji da za svaki amandman je potrebno napraviti glasanje što znači ne samo - ko je za - i ogromna većina! Nego, ko je za, ko je protiv, ko je uzdržan. Znači glasanje za svaki amandman a nakon toga glasanje za zakon u celini. Hvala.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Në rend të ditës është Projektligji mbi themelimin e Regjistrimit për të drejtat në pronat e patundshme. Unë shpresoj se në këtë ligj ka numër të vogël të amendamenteve. Amendamente ka vetëm neni 4.1. Urdhëro zoti Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra. Mua më vjen keq, unë në këtë ligj kam paraqitur disa amendamente të cilat sot me material nuk janë, nuk kërkoj arsytimin por më lejoni që unë ato ti paraqes dhe t'i prezentoj tani dhe nuk janë shumë. E para, është shumë e arsyeshme miratimi i Ligjit mbi themelimin e regjistrave mbi të drejtën mbi pronën e paluajtshme, por mendoj se para të bëhej kjo ka qenë dashur, edhe pse u theksua më parë, që të miratohej Ligji mbi pronësinë e Kosovës në bazë të të cilit do të sqaroheshin shumë çështje rreth pronësisë. Unë, megjithatë paraqes amendamentet plotësuese të cilat do ta begatojnë këtë ligj.

Neni 1 pika 1, u votua për këtë por e kam paraqitur si amendament që duhet shlyhet çdoherë sipas ligjit në fuqi sepse pikërisht me këtë ligj do të krijohej paralelizmi i ligjit.

Neni 1 pika 2: prona në momentin duhet të përputhet plotësisht me listën poseduese të pronarit të pronësisë, gjegjësisht Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe zyret kadastrale komunale do ta regjistrojnë pronën në librat kadastrale sepse në nenin dhe pikën që citova nuk janë të përcaktuara ku do të regjistrohen pronat. Neni 1 pika 3, duhet të jetë: "Përcaktimi i nivelit të pagesave për shërbimet e bëra të përcaktohet me Ligjin mbi taksat që e aprovon Kuvendi i Kosovës dhe jo mbi Agjencinë Kadastrale të Kosovës apo kuvendit komunal sepse po ashtu lejohen paralelizma dhe forma të tatimit të ndryshëm në mes të komunave dhe nivelit qendror.

Neni 2 pika 2: Regjistrimi i pronës do të bëhet në bazë të listës poseduese si bazë e pronës ngase ende nuk është definuar pronësia institucionale ngase kemi dallime të qarta në mes pronës private, shoqërore dhe asaj shtetërore.

Neni 2 pika 2, paragrafi d: Nuk është përcaktuar prona shoqërore sepse ajo buron nga nacionalizimi i pronave, konfiskimi i pronave dhe pronave urbane qytetare dhe këtu lindin konflikte rreth përcaktueshmërisë së pronarit të vërtetë të pronës e cila në sistemin shumëvjeçar ka kaluar dhe trajtuar në forma të ndryshme.

Neni 3 pika 2: Parashtruesi i kërkesës sipas Ligjit në fuqi duhet të plotësojë dokumentacionin mbi pronën por jemi dëshmitarë se prona ka lëvizë prej një pronari në tjetjrin pronarë dhe mbi ligjet diskriminuese serbe, në veçanti pas vitit 1990 pronari i vërtetë është tjetërsuar dhe ai nuk është më pronarë sepse ka lidhur një kontratë mbi shitblerjen ndërsa në veçanti te banesat të cilat janë marrë me vendimet nga institucionet, nga organizatat punuese, këtu kemi diskriminimin më të madh të bartjes së pronës prej një individi në tjetrin individ dhe definimi i sakt i pronës duhet të përcaktohet se prej cilit moment vlejné para suspendimit të organeve të Kosovës, vendime të cilat kanë qenë të plotëfuqishme dhe të miratuara. Do të thojja edhe dy fjalë.

Neni 3. pika 4, paragrafi i/e. Nëse dokumentacioni nuk është komplet dhe nuk paraqitet bazë për regjistrimin duhet përcaktuar procedura për kompletimin e dokumenteve për pronat të cilat janë marrë me reformat agrare dhe të cilat janë nacionalizuar dhe pa kurrfarë kompensimi nga shteti në thojza u është dhënë shtetasve gjegjësisht qytetarëve tjerë jo pronarë të kësaj prone.

Neni 3. pika 6: Regjistrimi i pronës do të bëhej pasi që vendimi të bëhet i plotëfuqishëm nga gjyqësia sepse kështu mbrohet mbrojtja e pronës nga rrezikshmëria. Dhe definitivisht po e përfundoj.

Neni 3. pika 7 Regjistrimi i pronës bëhet në bazë të dokumentacionit të lëshuar nga gjykata, pra duhet të lëshohen vetëm vendime gjyqësore dhe kontrata mbi shitblerjen të cilat janë bërë me metodat më jo të drejta pikërisht në këtë kohë.

KRESUESI:

Ju falemnderit. Unë po ia tërheq vërejtjen deputetit Kelmendi. Informata në Kuvend është që nuk janë bërë me shkrim këto sugjerime, prandaj nuk është lëshim i Kryresisë apo ose nuk i keni dorëzuar në adresë të caktuar ose ju jeni jurist prandaj ta ndjekni procedurën si për gjithë deputetët tjerë, prandaj procedojmë vetëm me ato amendamente të cilat janë bërë me shkrim dhe atë ka në nenin 4.1. Unë e kam informacionin se është aprovuar nga Komisioni ky amendament prandaj e konsideroj në qoftë se ndokush nuk pranon të dalë dhe ta kundërshtojë me arsyet pse, atëherë e konsideroj si të aprovuar amendament në ligj. Dhe është vërejtje në amendament në nenin 6.1, po ashtu është aprovuar nga komisionet dhe në qoftë se nuk e kundërshton këtë ndokush atëherë e konsideroj si amendament të aprovuar në votimin final të ligjit. Ju falemnderit dhe përfundimisht ju lutem në çdo mbledhje saherë që po aprovohet një ligj dhe te të gjitha ligjet një nen po na protegjohet, përmenden ligje, ligje e dispozita, unë nuk po dua me hy në atë, do të thotë i vetmi ligj që rregullon atë materie është ligji të cilin po e voton parlamenti dhe në herën tjetër kur të vijnë si filter nga Qeveria mos të na vijnë ligje me të njëtat nene të këtilla. Urdhëro zoti ministër.

JAKUP KRASNIOI:

Të nderuar deputetë unë dua të jap një sqarim. Ne thamë se ekziston dhe duhet të ekzistojë dhe duhet të aprovohen ligjet që e përbëjnë një kod mbi pronën dhe kodi mbi pronën përfshinë më shumë ligje sesa po aprovohen sot, sepse sot janë dy ligje: Ligji themelor mbi regjistrin e pronës së paluajtshme dhe Ligji mbi hipotekat. Aty ku përmenden ligjet e aplikueshme, nuk është fjala që është një dyzim i të njëjtit ligj. Është fjala për ligjet që nuk janë aprovuar në parlament dhe që merren me çështjen e pronës , prandaj mos ta ngatërrojmë këtë çështje. Do të thotë, aty ku përmendet ligji i aplikueshëm nuk është ligji që e aprovojmë ne por ligje tjera që kanë lidhje me pronën dhe që duhet të aprovohen në parlament dhe nuk duhet të kemi komplekse në këtë çështje. Përndryshe, për fushën që përfshihen me këto ligje, ligjet tjera nuk pranohen dhe me miratimin dhe aprovimin e këtyre ligjeve të gjitha ligjet që rregullojnë këtë sferë vetëvetiu pushojnë së ekzistuari. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Para se ta votojmë ligjin. Shqetësimet një herë i ka shprehur më kujtohet deputeti Muhamet Kelmendi dhe e kemi përkrahur. Profesoresha Dauti disa herë. Ju zoti Kelmendi me plotë të drejtë. Ne në rend të ditës procedojmë vetëm me ligjet që i keni prandaj i përkrahim në parim dhe kjo le të mendojnë Qeveria dhe komisionet për të gjitha këto. Kush dëshiron fjalën.

SLOBODAN BIJELIĆ:

Poštovano Predsedništvo, za današnje plenarno zasedanje Skupštine mi smo kao koalicija "Povratak" u ponedeljak 14-tog dali dva zahteva sa formulacijom, znači postoji tekst napisan u ta dva zahteva i tražili smo u principu da taj materijal udje kao matgerijal za današnje zasedanje na plenumu. Pošto članovi Predsedništva koalicije "Povratak" nisu učestvovali na sednici Predsedništva u utorak 15.10. pa nismo dobili od njih odgovor zašto ta dva zahteva nisu razmatrana, ja bih prije znači vašeg davanja na glasanje predloga oba zakona zatražio da mi odgovorite zašto taj materijal, znači ta dva zahteva koalicije "Povratak" nisu uvrštena u materijal za današnji plenum. Hvala.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Unë e kam informacionin që nuk kanë ardhur amendamente nga koalicioni "kthimi" por kanë ardhur rekomandime, prandaj respektoni procedurën. Profesor Bajrami e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë. Mendoj se në disa projektligje po na paraqitet ky problemi i ligjeve të aplikueshëm. Ne e dijmë se ç'është ligji i aplikueshëm dhe me Rregulloren 19/24 është përcaktuar. Por, në të gjitha rastet kur Kuvendi i Kosovës do të miratojë ligj ai ligj do të jetë i aplikueshëm për ne dhe të gjitha dispozitat që e kanë rregulluar atë çështje më parë, zëvendësohen dhe nuk mund të kemi dualitet dhe legjislacione. Mendoj se këto paqartësi po na paraqiten edhe për faktin se nuk kemi një filtër përfundimtar që do të bëjë harmonizimion përfundimtar të ligjeve. Me rregulloren e

re të punës, të cilën do ta keni shumë shpejt të përgatitur. Ne kemi paraparë që çdo ligj të shqyrtohet në Komisionin për çështjet legislative dhe kushtetuese dhe ai komision të bëjë një lloj pastrimi dhe të krijojë një harmonizim të ligjeve për arsye se po shifni në të gjitha draftet e projektligjeve të dispozitat kalimtare kemi këtë problem. Ky Kuend ka fuqi ligjdhënëse, ka fuqi ligjdhënëse bile në disa fusha fuqi ligjdhënëse të plotë, në ato fusha që janë të transferuara dhe në momentin kur ne e sjellim një ligj të Kosovës ai është i vetmi ligj i aplikueshëm. Mos të na krijohet validiteti e të na shkapërderdhet lejislacioni kështu që mendoj se pas miratimit të Rregullores së re të punës nuk do t'i kemi këto probleme por tekstet sadopak do të jenë të harmonizuara.

KRYESUESI:

Profesor, falemnderit. Mendoj se një herë ju kemi përkrahur dhe mendojmë se është në rregull.

Pyes deputët – kush është për aprovimin e Ligjit në tërësi me amendamentet e aprovuara, ju lutem? Po, edhe me ato korigjimet e dispozitave përfundimtare, kuptohet. Kush është kundër aprovimit? A abstenuan ndokush nga votimi?

Votimi – Glasanje - Voted

Për – Za – For: 69,

Kundër – Protiv – Against: 11

Abstenuan – Uzdržanih – Abstained: -

Prandaj, e konsideroj si të aprovuar në Parlament. Ju falënderoj të gjithëve për kontribut. Në rend të ditës kemi: përkrahja e emërimit të anëtarëve të komisioneve për barazi gjinore dhe personat e zhdukur. Besoj se i keni emrat. Ne në parim gjithmonë kemi votuar, është e drejtë e grupeve parlamentare prandaj me një votë formale – kush është për emrat e propozuar për këto komisione? Ju falemnderit. A ka kush kundër, asnjë kundër. A abstenuan ndokush? Askush. Njëzërit u aprovua. Ju falemnderit.

Në rend të ditës është parashtrimi i pyetjes së zotit Arsim Bajrami – Ligji për arsimin e lartë. Pyetja është bërë me kohë i është procedu ministrisë përkatëse. Ministri ishte në

fillim të mbledhjes, kërkoj falje për angazhime të marrura dhe luti që të marrë fjalën në atë kohë. Unë thash ne kemi aprovuar rendin e ditës dhe nuk ka ekskluzë, nuk mund të dalë jashtë asaj, u munduam me marrë në shërbimet e Sekretarisë, është sigurisht në ndonjë mbledhje tjetër dhe nuk kemi akses në telefonin e tij, prandaj urdhëro profesor Bajrami.

ARSIM BAJRAMI:

Në pajtim me Rregulloren e përkohshme të punës dhe me udhëzimet për parashtrimin e pyetjeve parlamentare, unë kam parashtruar pyetjen të cilën i kam adresuar Përfaqësuesit special të Sekretarit të përgjithshëm, kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë. E di që si deputet në radhë të parë pyetje mund t'u bëhen vetëm qeverisë dhe ministrive por unë kam kërkuar vetëm sqarim meqenëse bëhet fjalë për autoritetin ligjdhënës të këtij Kuvendi. Pas diskutimeve disamujore në dy-tri seanca ne diskutuam Ligjin për arsimin e lartë dhe pas komplikimeve që kshim rreth këtij ligji ne proceduam për këtë ligj dhe pas leximit të tretë Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar këtë ligj. Po e përsëris se ky ligj bën pjesë në sferën e kompetencave që janë bartë te autoritetet e Kosovës. Pra është një ligj ku i njihet autoriteti plotë këtij Kuvendi. Në bazë të Kornizës kushtetuese, në bazë të rregullës 9.44 ligjet e Kuvendit të Kosovës i nënshkruan kryetari i Kuvendit dhe i përcjell për procedim dhe shpallje te përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm. Edhe pse ka kaluar gati një muaj i plotë, ky ligj ende nuk është shpallur, nuk është dekretuar nga e përfaqësuesit special të sekretarit të përgjithshëm dhe në një mënyrë fati i këtij ligji është akoma pezull. Në anën tjetër edhe pse po botohet fletushka zyrtare e UNMIK-ut ky ligj akoma nuk është hyrë në radhë për t'u botuar dhe për t'u njoftuar qytetarët. Mendoj se kjo është një sfidë serioze për ne si Kuvend për shkak se mosnënshkrimi dhe komplikim i nënshkrimit të tij po e kompromiton edhe idenë e vetëqeverisjes substanciale. Në qoftë se ne na bëhen probleme edhe në këto ligje që janë plotësisht kosovare, atëherë për çfarë vetëqeverisje substanciale do të ketë Kosova. Mendoj se në këtë raport duhet të spastrohemi edhe me autoritetet e përfaqësuesit special në mënyrë që të mos kemi konflikte aty ku nuk duhet të kemi. Ky ligj nuk prek kompetencata e rezervuara dhe as që është dashur të komplikohet procedura. Përmes kësaj pyetje unë kam dëshiruar ta aktualizoj këtë çështje dhe kërkoj që për mbledhjen e ardhshme të kam përgjigje me shkrim në mënyrë që vërtetë ne si Kuvend të mbrojmë autoritetin tonë dhe të japim kuptim punës tonë në mënyrë që neve të bijmë ligje e ato të

mos nënshkruhen. Në anën tjetër, ju e dini se Përfaqësuesi special e ka një mundësi të përdorjes së vetos që sot vërtetë në të gjitha shtetet parlamentare është një veto e rrëzueshme, është një element monarkik që e ka përmbajtur korniza kushtetuese, por ai mund ta përdorë një mekanizëm të tillë vetëm kur preken kompetencat dhe autoritetet e tij me Rezolutë 1244. Në këtë rast, ai autoritet nuk preket dhe ky ligj duhet të nënshkruhet sa më parë. Rëndësia e nënshkrimit të këtij ligji është urgjente për çështje të reformimit të arsimit të lartë. Ne kemi filluar një reformë dhe shumë çështje po presin apo po ngadalësohen pikërisht për shkak të moshyrjes të këtij ligji. Kështu që apeloj edhe te autoriteti i kryetarit të Kuvendit që të ndër marrë gjithçka që vëtetë ligji të nënshkruhet sa më shpejt.

KRYESUESI:

Ju falemnderit zoti Bajrami. Kryeministri ka ardhur në sallë dhe e ka fjalën zoti Osmani.

REXHEP OSMANI:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë. Ne në Kuendin e Kosovës më 25 korrik i miratuam dy ligje të sistemit të arsimit për Kosovën, dy ligjet e përgatitura nga një grup i Këshillit të ekspertëve të Këshillit të Evropës në bashkëpunim me ekspertët e Kosovës, me sugjerimet e disa ekspertëve nga Universiteti, me ekspertët ndërkombëtarë të Zyrës ligjore në Ministrinë e Arsimit dhe ishte një rrugë e mirë, pastaj me Zyrën ligjore të kryeministrit, Zyra ligjore e Kuvendit, për të mos i hyrë historisë dhe gjithë asaj sepse deputetët janë të informuar edhe për procedurën e miratimit të atyre dy ligjeve. Pyetjen të cilën e ka parashtruar deputeti Bajrami kanë të bëjnë pse nuk janë dekretuar këto dy ligje. Kjo pyetje ndoshta iu ka adresuar Ministrisë së Arsimit. Ministria e ka kryer punën e vet, Qeveria dhe iu kanë proceduar Kuvendit. Këtë pyetje duhet shtruar Kuvendit të Kosovës por sipas informatave që kam marrë si rezultat i presionit për të dhënë përgjegje për dekretimin e këtyre dy ligjeve dhe si nevojë imediate e Ministrisë së Arsimit për t'i pasur ligjet dhe për të filluar nxjerrjen e udhëzimeve administrative të cilat Ministrinë e obligojnë ligjet e miratuara në Kuvend unë kam shtruar këtë çështje disa herë dhe informacionet e para janë se ato nuk janë dorëzuar në Zyrën ligjore të Përfaqësuesit special dhe nuk i ka parë për nënshkrim. Mirëpo, sipas deklaratës së zëdhënësës së

UNMIK-ut mbrëmë, del se ka problem rreth çështjes së nënshkrimit të Ligjit mbi arsimin e lartë. Unë vetëm mund të ju them se tani ajo nuk është më përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit ashtu siç ka nevojë parlamenti që ligjet e miratuara të tij të nënshkruhen, Ministria ka nevojë të shumëfishtë dhe institucionet e arsimit të lartë, të shkencës, presin dekretimin e këtij ligji. Unë si ministër i arsimit nuk kam marrë asnjë hap pa dekretimin e këtij ligji edhe pas nënshkrimit të kryetarit të Kuvendit meqë nevojitet një procedurë e tillë. Procedurat që kanë rrjedhë në këtë kanë qenë të filla që deri më 25 shtator kur është kryer edhe diskutimi mbi propozimin e amendamentit të grupit apo të panellit që më mirë të kuptohet, propozimi i amendamentit nga kryesuesi i panellit, jo nga panelli, pas vendimit të Kuvendit të Kosovës mendoj se çdo gjë ka përfunduar sa i përket miratimit të këtij ligji nga ana e Kuvendit dhe po ashtu kisha dëshiruar që të mos ketë konflikte rreth nënshkrimit të këtij ligji për arsye se siç e tha edhe profesor Bajrami janë probleme të rënda dhe janë obstrukcione të shumta në punën e Ministrisë dhe praktikisht Ministria nuk mund ta kryejë veprimtarinë e saj në qoftë se nuk ka ligjet e dekretuara dhe ne nuk do të themi se disa dispozita jemi të obliguar që t'i aplikojmë, jemi të detyruar por kishte me qenë mirë që ne mos të bëjmë diçka jashtë asaj procedure dhe të drejtës që ka përfaqësuesi special për dekretimin e ligjit. Ne kemi qenë të disiplinuar, kemi qenë korektë dhe nuk kemi nxjerrë asnjë akt deri më tani. Por, në qoftë se vazhdon kjo vonesë e shpalljes së ligjeve atëherë Ministria është para një akti shumë të rëndë të kryerjes së veprimtarisë dhe punëve të saj. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ministër, ju falemnderit. Një informacion. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka qenë e shqetësuar nga informata që e kam marrë që ligji nuk i është përcjellë Zyrës së zotit Steiner për... Menjëherë, pas përfundimit të procedurës parlamentare i është dërguar shkresë dhe unë e kam kërkuar kopjen e shkresës, sekretari më ka njoftuar edhe për orën dhe minutën kur ka mbërrit në zyrën e zotit Steiner, prandaj çdo informatë që nuk ka mbërrit në kohë pas përfundimit të procedurës, sepse ju e dini që në kohë të lejuar sipas Kornizës kushtetuese koalicioni "kthimi" ka bërë vërejtje në atë brenda orëve të caktuara, është caktuar paneli, është proceduar në Parlament sipas të gjitha dispozitave, Parlamenti ka marrë vendim për atë ligj dhe vendimi i është dërguar në adresë të zyrës së zotit Steiner. E mbështes edhe një herë plotësisht, të mos humbim kohë, pa e komentuar fare diskutimin e zotit Bajrami, se edhe një herë kemi debatuar për këtë çështje dhe kërkoj

që ajo të zbatohet dhe Ligji të hyjë në fuqi, në veprim. Prandaj, mendoj se ky është vendim i Parlamentit dhe nuk është mirë që këtë përsëri ta shqyrtojmë.

Ke të drejtë me rregullore, konstitucionalist je, urdhëro profesor.

ARSIM BAJRAMI:

Parimisht duhet të sqaroj, nuk kam ngritur mocion interpelance por kam bërë një pyetje me motiv që ta mbrojmë autoritetin e këtij Kuvendi të Kosovës. Ne kemi pruar një ligj, kemi votuar këtë ligj me një procedurë që është komplikuar pa nevojë. Nuk është dashur të komplikohet aq shumë. Dhe insistojmë që vendimet dhe votimet e parlamentit të respektohen. Ka një muaj ditë që Parlamenti e ka votuar atë ligj. Ligji është pezull. As nuk e ka nënshkruar e as nuk e ka përdorur veton. Atëherë, cila është arsyeja që ne këtu votojmë dhe nxjerrim ligje. Idea ime është që të procedojmë më shpejtë. Unë, këtu jam i sigurt, që ka përgjegjësi të Sekretarisë. Është dashur që ditën e nesërme kur Kuvendi e ka votuar Ligjin pas leximit të tretë, Ligji t'i përcillet menjëherë Përfaqësuesit special. Nuk jam i sigurt se është bërë kjo. Dhe, ne juristët e dijmë se në qoftë se përfaqësuesi special nuk e përdorë të drejtën e vetos në afatin e caktuar, atëherë heshtja është miratim, është pranuar dhe ky ligj duhet të zbatohet. Jo të vijmë në një pozitë që ministri të pret implementimin e ligjit për shkaqe formale. Në qoftë se në një afat të caktuar, që është afat standard prej 8 ditëve nuk nënshkruhet ligji, atëherë ai është pajtuar dhe ligji duhet të zbatohet e jo kështu ne për një muaj të ngelim pezull e mos ta dijmë fatin e atij ligji.

KRYESUESI:

Profesor është proceduar ashtu siç ju thash, keni të drejtë të mos besoni, mund të kërkoni ta shifni dokumentin, unë dokumentin e kam në zyre. Nën të ndryshme, i lus deputetët ashtu siç ka vepruar profesor Bajrami. Ata që kanë pyetje për Qeveri, jo gojarisht kurgjë, zoti Tomë Hajdari, me shkrim i çoni dhe të procedohet me rregull dhe vërtetë t'i thirrjmë në interpelancë të gjitha ato institucione, të gjithë ata individë që i duhen Parlamentit për sqarime. Vetëm pra po ju përkujtoj... Tomë, a ke ndoshta diçka speciale? Urdhëro.

TOMË HAJDARI:

Unë e pash të arsyeshme këtu të dal para jush që shkresën që ia kemi dërguar Kuvendit të Kosovës, gjegjësisht Kryesisë së Kuvendit të Kosovës me datën 10.6.2002 parashtruar nga Komisioni parlamentar për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural të Kosovës ku decidivisht thuhet: Komisioni parlamentar për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 10.6.2002 unanimitisht ka vendosur që t'i drejtohet Kryesisë së Kuvendit të Kosovës me kërkesën urgjente që të vendosë në rend të ditës në seancën e vet nxjerrjen e një vendimi të përkohshëm për pylltarinë e Kosovës i cili do ta rregullonte sistemin e pylltarisë deri në nxjerrjen e një ligji të pylltarisë. Për këtë nevojë urgjente nisemi duke pasur parasysh gjendjen katastrofike dhe shumë të rëndë në Kosovë. Krahas kësaj ne kemi patur edhe disa takime me organet ekzistuese të pylltarisë së Kosovës e posaçërisht me Kryesinë në Sindikatën e pavarur të pylltarisë së Kosovës. Këtë kërkesë tonën e ka mbështet edhe Komisioni parlamentar i mjedisit dhe planifikimit hapësiror. E them këtë sepse është sezonë e paradimrit dhe pyjet tona po shkatërrohen tejmasë, në mënyrë katastrofike dhe në të gjitha format. Forma më shqetësuese është se sot nëpër tregjet e Kosovës depërtojnë drutë e prera edhe me vulë inekzistence "Serbia shuma". Të shiqojmë kush çka dhe kush jep urdhëra që këto vula të përdoren nëpër druat që konzumon Kosova. Unë mendoj se këtë edhe rregulloret e UNMIK-ut këtë çështje e ndalojnë dhe e kanë parasysh. Unë për këtë çështje dola, shoku kryetar. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Ka qenë në Kryesi një kërkesë e këtillë. Kryesia nuk ka parë të arsyeshme me vë në rend të ditës. Kjo nuk do të thotë se nuk jemi të gjithë të shqetësuar për këtë...

LIRAK CELAJ:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë. E dij procedurën do të thotë ta bëjë me shkrim, dhe të bisedohet për një temë, por megjithatë mendoj se është një temë shumë e rëndësishme dhe fatkeqësisht po anashkalohet nga Parlamenti dhe e kemi këtë obligim ndaj elektoratit që të bisedojmë. Është çështja e materieve me elemente radioaktive që është zbuluar në Mitrovicë dhe ne nuk po reagojmë. Unë mendoj se çdo shtet perëndimor, secili shtet demokratik do të reagoonte për këtë çështje shumë alarmante për sigurinë e Kosovës dhe kisha kërkuar që në seancën e ardhshme një përfaqësues i Trupave të Mbrojtjes së Kosovës të dalë këtu të na raportojë më detajisht lidhur me këtë rast, pasi që ata janë

zbuluesit e parë, pastaj Shërbimi policor i Kosovës apo KFOR-i, UNMIK-u dhe të dalin e të bëjë një raport dhe të na informojnë ne më shumë se çka ka ndodhur dhe cila është origjina e këtij elementi dhe besoj se nuk duhet të heshtim lidhur me këtë çështje kaq serioze. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Unë mendoj që është shumë e qëlluar, por ju lutem mos të anashkalohej, ne mund t'ia adresojmë Ministrisë në rend të parë sepse e kemi Ministrinë e ambientit dhe ata le t'i thërrasin të gjithë dhe le të bëhet meqë ka kohë deri në mbledhjen e ardhshme me shkrim, bëjeni në formë të pyetjes së deputetit dhe ne plotësisht e përkrahim. Urdhëro zoti Prekopuca.

GANI PREKOPUCA:

Vërtetë e di procedurën e pyetjeve por kësaj radhe mendoj se është urgjente prandaj desha që megjithatë ta njoftoj këtë Kryesi të Kuvendit sepse në komunën e Fushë-Kosovës ju lutem na kanë pikur 5000 votues serbë të cilët deri sot nuk kanë qenë askund të regjistruer. Pjesë Kryesinë, këtu i kam elementet të gjitha, me të gjitha regjistrimet, ata tani në 2002-tën, tash ekzistojnë 5000 votues të cilët nuk janë nga Kosova, të cilët nuk e dijmë çfarë letërnjoftimesh kanë por që janë regjistruar në Fushë-Kosovë. Ju lutem për një minut që do të ju informoj dhe ta keni pasqyrën se çka është kah ndodh. Viti 1991, banorë serbë kishte 8.445 në komunën e Fushë-Kosovës. Në vitin 2000 komplet votues të të gjithë etnive kishte 12.121 votues. Në vitin 2001 kemi kompletë votues do të thotë të të gjitha etnive 16.652. Në vitin 2002, tash në regjistrat për votues janë 24.313. Prej tyre ne që i kemi identifikuar serbë janë 7.414 votues; hashkalinjë 2000, çka do të thotë rreth 40% numri i votuesve të tjerë - serbë dhe hashkalinjë është në komunën e Fushë-Kosovës. Në shërëbimin civil komunal 2001-2002 nga zgjedhjet parlamentare nacionale deri tash te këto 2002-tës janë regjistruar gjithsej 845 banorë, po e përsëris – vetëm 845 banorë, nga moshë 16 vjeçare e përpjetë. Shtrohet pyetja – nga u rritën 5000 votues serbë? Kush i përpiloi këto lista? Sipas OSCE-së në Fushë-Kosovë duhet të jenë përfshirë 34.000 shqiptarë dhe rreth 4000 serbë dhe të tjerë që nuk përputhet me regjistrin e votuesve. Sipas regjistrave të

votuesve prej 24.313 komuna e Fushë-Kosovës do të kishte dashur t'i ketë 50.000 banorë!?

Këto janë fryerje të regjistrave të popullsisë joshqiptare. Pyetja e dytë shtrohet – kush i ka përpiluar këto lista gjegjësisht këto regjistra? Cilat janë burimet e të dhënave të regjistrave për votues? A janë burime këto të Serbisë, Jugosllavisë apo të UNMIK-ut, kur - me sa dihet, UNMIK-u për këtë shifër prej 5000 votuesve nuk ka lëshuar asnjë letërnjoftim. Ju lutem këtë shqetësim e paraqes për arsye se në komunën tonë veç tash paraqitet shqetësimi se do të manipulohet me votuesit. Kaq pata unë.

KRYESUESI:

Ju falemnderit zoti deputet. Unë vetëm një informacion. Ka patur edhe kërkesë zyrtare nga një komunë dhe nga një kryetar i një komune. Këtë shqetësim Kryesia e ka shqyrtuar në prezencën e ambasadorit Fieski dhe ne i kemi shprehur shqetësimet tona. Unë nuk po e emërtoj, por merreni me mend kryetari i komunës, kryetari aktual i komunës nuk ka të drejtë votimi në këto zgjedhje. Do të thotë ka absurditete të këtilla që do të thotë, unë nuk

ju kundërshtova zoti Prekopuca, por edhe këto zgjedhje janë të organizuara edhe nga OSBE-a siç e dini, edhe nga institucione tjera ndërkombëtare. Shqetësimet janë me vend të gjithë qytetarëve të Kosovës, të parlamentarëve në veçanti dhe të Parlamentit, por Parlamenti si parlament i ka shprehur zyrtarisht brengosjet e veta dhe mirë është që e debatuar këtë por nuk mundemi të nxjerrim kurrfarë vendimi. Unë në fund ju falënderoj për pjesëmarrje dhe për kontributin tuaj. Shihemi në seancën e ardhshme. Ju falemnderit.

MBLEDHJA MORI FUND NË ORËN 12⁵⁰.

